



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister**

***Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics***

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010  
Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* ,  
shpallë:

**KONKURS**

**1. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit , dy (2) pozita të karrierës:**

**Titulli: Një ( 1) Udhëheqës i zyrës rajonale të statistikës në Pejë**

**Numri i referencës : ASK-DRA-001**

**Koeficienti : 8**

**Detyrat dhe përgjegjësit :**

1. Është përgjegjës për planifikim , realizimin dhe mbikëqyrjen e punëve në zyrën rajonale të statistikës në Pejë.
2. Koordinon punët me departamentet prodhuese të ASK , në realizimin e programeve të kërkimeve statistikore në Pejë , Istog dhe Klinë që i mbulon kjo zyre.
3. Kujdeset për trajnimin e personelit , përvetësimin e metodologjisë dhe pyetësorëve nga ana e personelit ,
4. Organizon ndarjen e punëve për personelin e zyrës , kujdeset për dinamikën e punëve , bënë sistemimin , klasifikimin dhe kontrollin logjik të të dhënave të grumbulluara ,
5. Është përgjegjës për menaxhimin profesional të personelit si dhe ndërtimit të raporteve efektive me punëtorët e zyrës në pajtim me Ligjin e Shërbyesve Civil ,
6. Është përgjegjës për menaxhimin e mirë të pasurisë të kësaj zyre,
7. Zhvillon raporte të mira bashkëpunimi me responentet dhe shfrytëzuesit e të dhënave statistikore në rajonin që e mbulon kjo zyre ,
8. Propozon dhe delegon në pajtueshmëri me Drejtorin e departamentit të regjistrimit dhe anketimit dhe Udhëheqësin e divizionit të anketimeve , për të punësuarit në këtë zyre në aftësimin profesional dhe trajnime të nevojshme ,
9. Merre pjesë në aktivitetet tjera sipas kërkesës së Drejtorit të departamentit të regjistrimit dhe anketimit si dhe Udhëheqësit të divizionit të anketimeve dhe divizionit të regjistrimeve , bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës,
10. Raporton tek Udhëheqësi i divizionit të anketimeve për dinamikën e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar ASK-ja.

**Kualifikimi :** Diploma universitare ne fushën juridike ose ekonomike , apo te ngjashme.

**Përvoja e punës:** kandidati duhet të ketë se paku 4 vite përvojë pune.

**Kompetenca dhe aftësitë:**Kandidati duhet të ketë aftësi të komunikimit për pune ekipore , aftësi ne përdorimin e kompjuterit (Wordit , Excelit , Outlook) , te ketë aftësi te ruajtjes se konfidencialitetit të të dhënave që kanë të bëjnë me punën.

**Titulli: Një ( 1) Zyrtar ne zyrën rajonale te statistikës ne Gjilan**

**Numri i referencës : ASK-DRA-002**

**Koeficienti : 6**

**Detyrat dhe përgjegjësit :**

- Kryen anketat për të gjitha hulumtimet statistikore në nivel të rajonit të Gjilanit,
  - Zhvillon Anketën mbi buxhetin e ekonomive shtëpiake, në ekonomitë familjare, intervista,shpërndarjen ditarëve , plotësimin anketave, udhëzon për plotësimin e ditarëve të shpenzimeve, vizitat javore në ekonomitë familjare , përfshirjen dhe kontrollimin i informatave të mbledhura në Anketën mbi buxhetin e ekonomive shtëpiake,
  - Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Raporteve tremujore të hotelerisë dhe turizmit,
  - Shperndan,ploteson,kontrollon dhe sistemon Raportet mbi Statistikat e Arsimit(shkollave),
  - Shperndan,ploteson,kontrollon dhe sistemon Raportet mbi Statistikat e kulturës dhe sportit,
  - Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të industrisë dhe të ndërtimtarisë,
  - Zhvillon raporte të mira me responentët,
  - Udhëzon plotësimin e formularëve të anketave statistikore,
  - Bënë kontrollimin dhe analizën logjike të hulumtimeve statistikore ,
  - Kujdeset për shpërndarjen, distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në teren ,
  - Me kërkesën e udhëheqësit të zyrës rajonale , përcjell dhe monitoron personat e angazhuar në teren gjatë procesit te implementimit te projekteve të planifikuara nga ASK-ja ,
  - Raporton te udhëheqësi i zyrës rajonale për dinamiken e aktiviteteve .
- Kualifikimi :** Shkollimi i nivelit bachellor dhe trajnime ne fushën përkatëse.
- Përvoja e punës:** kandidati duhet përvojë relevante se paku 4 vite përvojë pune.
- Kompetenca dhe aftësitë:** Njohja e kompjuterit (Word ,Excel,Outlook) ,
- Bashkëpunimi ne mënyrë ekipore e nevojshme,
  - Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

**Procedura e konkurimit:**

Ne Shërbimin Civilë kane te drejte te punësohen shtetasit e Republikës se Kosovës te moshës madhore ,te cilët kane zotësi te plote për te vepruar,përgatitje te nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe te cilët kane aftësi fizike qe kërkohen për pozitën përkatëse.

**Aktet ligjore dhe nënligjore qe e rregullojnë rekrutimin:**

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë behet ne pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Republikës se Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit ne Shërbimin Civilë.

**Kohëzgjatja e emërimit:**Sipas Ligjit te Shërbimit Civil te Republikes se Kosoves , ne te cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

**Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit ne mjetet e informimit publik.**

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave te Kosovës,Rr,"Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën ,vertetimin nga Gjykata qe personi nuk eshte nene hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Kërkesat e derguara pas dates se fundit nuk do te pranohen.Kërkesat e pakompletuara do te refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyren e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

***“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.***

***“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.***